

FJALA E DEPUTETIT EDUARD NDRECA

E HËNË 31 TETOR 2022

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë, shumë të nderuar qytetarë!

Teksa lexohej sot projekti i opozitës, ku, ndër të tjera, u tha se në emër të shërbimit ndaj qytetarëve, pra, në emër të popullit, do ta ndajmë Bashkinë e Mirditës në dy bashki, m'u kujtua ajo shprehja dikur: "Në emër të popullit", që e copëtoi dhe e ndau Mirditën, por që nuk ishte as në emër të popullit, as për popullin. Gjithsesi, për Mirditën dhe për Lezhën do të flas pak më poshtë.

Kemi kaluar në këtë komision një sërë dëgjesash (po flas si anëtar i këtij komisioni tashmë), mbi 40 të tilla, ku janë ftuar të gjithë ata që kanë propozuar dhe janë dëgjuar dhe janë pyetur me kujdes të gjithë. Personalisht jam përpjekur ta ndjek me seriozitet dhe me qetësi punën e komisionit, për të marrë më të mirën e asaj që thuhet aty nga specialistët dhe i bindur në fillim se ndanim, së bashku me opozitën, dëshirën e mirë për ta korrigjuar reformën e vitit 2014, në mënyrë që disa gjëra të funksiononin më drejt edhe më mirë, duke filluar nga decentralizimi.

Po ashtu në fillim mendova se opozita ndahej te harta me ne, pasi e konceptonte ndryshe zhvillimin e territorit dhe se vërtet ishte e bindur se reforma e vitit 2014 në aspektin territorial nuk kishte funksionuar. Dakord, kjo ishte qasja e tyre dhe shumë mirë, asgjë të keqe nuk ka. Europa ofron sa e sa modele, të gjitha të suksesshme, ndaj dhe kërkesa e opozitës në krye të herës më dukej logjike për ata, por në fund, kur të vjen në dorë një raport i papritur i opozitës dhe sheh se ai raport nuk prodhon asgjë të re, as në konceptin e ndarjes së territorit, as të funksionimit të njësisë, habitesh besoj. E kupton se gjithë ajo mori dëgjesash për ta ishte kot dhe se opozita nuk kishte arritur dot të ndërtonte një projekt dinjitoz, që t'ua ofronte qytetarëve, por thjesht një projekt politik për të kënaqur interesat e disa kandidatëve të paracaktuar ose një ndarje në logjikën partiake që mundëson fitimin e disa njësive. Çfarë ndryshon kjo harta e re opozitës? Kush ma thotë: çfarë është ky model i ri? Njësitë që propozon opozita, çfarë janë bashki apo komuna? Ose i duhet qëndruar strikt një modeli ose të kopjosh modele, besoj se nuk është në nderin e askujt. Kemi 61 bashki, i bëmë 94 bashki, çfarë kemi ndryshuar? Ma thotë dot opozita se çfarë ka ndryshuar?

E merrni kot, Xhelal, modelin e Kroacisë, se Kroacia kishte komuna edhe me 700 banorë dhe funksiononte krejt ndryshe. Më thuaj ku ngjason projekti juaj me projektin e Kroacisë? Ku përafrohet ky model që na keni sjellë sot? E kuptoj që ju gjatë dëgjësave në komision u gozhduat edhe nga ekspertët që sollët vetë, të cilët e sollën modelin e para vitit 2014 si tërësisht të dështuar dhe atë të vitit 2015 e këtej si një model të stabilizuar dhe që po funksiononte, në fakt, qoftë me rritjen e të ardhurave, qoftë me investimet, madje u çoroditët edhe më shumë, kur edhe ekspertët tuaj deklaruan se pas 2019-s bashkitë në rang vendi po performojnë edhe më mirë, po bëjnë investime vetë, madje kanë arritur t'i shtojnë shumë investimet e tyre jo vetëm ato që u jep qeveria.

Pra, këtu kemi dy aspekte: bashkitë po performojnë dhe reforma ishte e vlefshme. Nga ana tjetër, bashkitë ishin të gjitha socialiste dhe ju e kuptoni vetë këtë. Nuk do të ndalem shumë në reformën në tërësi, sepse i përmendi kolegja e nderuar Denaj, por po ndalem në dy shembuj: në shembullin e Mirditës dhe të Lezhës. Pikë së pari, për Mirditën dy bashki thoni ju: Oroshi dhe kjo tjetra, që nuk e di sesi e ka emrin, do të ma thotë bashkëkryetarja. Bashkia e Oroshit dhe bashkia tjetër është Bashkia e Mirditës besoj, po nëse e quajmë Mirditë kemi hequr nga Mirdita zemrën e saj, Oroshin. Sesi e vendos emrin bashkëkryetarja, nuk e di.

Se çfarë zgjidhet me këtë ndarje në Mirditë, nuk kam arritur dot ta kuptoj! Dy njësi administrative bashkohen, 5 të tjera mbeten ashtu siç ishin. Ku është ndryshimi? U ofrojmë shërbimet Oroshit dhe ish-komunës së Fanit dhe lëmë 5 njësitë e tjera ashtu siç kanë qenë! Ku e kemi zgjidhjen për Mirditën? Kjo është tërësisht artificiale dhe nuk imponon asgjë më shumë, përveçse dy kandidatë, me shpresën se mund të fitohen zgjedhjet atje. Madje e veçanta është se qendrën e komunës së Oroshit e zhvendosin në Reps dhe për ata që nuk e dinë, Oroshi është qendra e Mirditës tradicionalisht për shekuj me radhë, që e ka drejtuar Mirditën që nga fillimi i pushtimit osman, e më pas. Duro do ta them dhe këtë! E prishi në emër të popullit "Ai", dhe doni ta prishni edhe ju po në emër të popullit. Në fakt, Partia Socialiste e bashkoi, ndonëse ka nevojë dhe për ca korrigjime të tjera nga ajo e vitit 2014.

Zoti Sula, e ka drejtuar familja e Gjonmarkajve me kanun, me zakon dhe ju thoni sot se, me gjithë administratën, ligjet e të tjera si këto, nuk po funksionon kjo bashki. Nuk e di sesi do t'ia vendoni emrin ju kësaj? Bashkia e Mirditës sot është e ndërtuar si duhet dhe ka nevojë vetëm për disa rregullime territoriale, por, ato pjesë që padrejtësisht i janë hequr, bashkohen me Bashkinë e Mirditës, sepse është një nga trevat më në zë, më e lidhur, më me traditë, më me histori, kështu që në aspektin edhe të asaj që ne kemi propozuar në komision, sugjeroj që, me kalimin e kohës, të bëhen disa rregullime territoriale

edhe në Bashkinë e Mirditës, por kurrsesi të ndahet në këtë mënyrë, tërësisht të çrregullt, siç është propozuar në projektin e opozitës.

Kam edhe një shembull tjetër, shembullin e Bashkisë së Lezhës, ku në këto 3 vjet është investuar sa nuk është investuar në 30 vjet të marra së bashku. Është investuar në çdo komunë sa asnjë bajraktar apo kryetar komune, që e ka mbajtur atë post për 30 vjet nuk ka investuar. Kush më thotë: si funksionon më mirë, kështu apo e copëtuar? Normalisht që kështu dhe jam shumë i bindur që edhe ju me kalimin e kohës do ta kuptoni se modeli që ne kemi zgjedhur është i duhuri. Pa dyshim që duhet të sjellim dhe ato ndryshime që janë propozuar, t'i realizojmë dhe ato ndryshime në mënyrë që kjo të funksionojë si duhet, por keni dhe një qasje krejt të kundërt me veten. "T'i mbështesim institucionet e reja" - thoni publikisht, pra ato të drejtësisë e të gjitha institucionet e reja. Vetë bashkitë sot janë institucione të reja dhe kanë nevojë për mbështetje. Kur do të heqim dorë nga ideja që një reformë të bërë për pak vite ta zhbëjmë e të fillojmë të krijojmë sajesa të tjera? Jam bindur që edhe ju do të ftilloheni dikur! Ju faleminderit!